REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA BURIMORE PËR NXËNËSIT QË NUK DËGJOJNË TIRANË

Rruga "Hafëz Ibrahim Dalliu" Nd.5 ; Tel 069 608 2456 ; Email:institutinxnukdegjojne@yahoo.com

SHPALLJE E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS PËR POZICIONIN "SPECIALIST NË DEPARTAMENTIN E IDENTIFIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË NEVOJAVE ARSIMORE TË NXËNËSVE ME AK"

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;
Ligji nr.7995, datë 20.09.1995, "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar;
Ligji nr.93/2014, datë 31.07.2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara";
VKM-në nr.148, dt. 13/03/2024 "Për kriteret dhe procedurat për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e institutioneve të arsimit special në Qendra Burimore, si dhe për mënyrën e organizimit e të funksionimit të tyre";
Urdhri i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.449, datë 29.08.2024 "Për miratimin e riorganizimit të institucionit "Instituti i Nxënësve që Nuk Dëgjojnë" në Qendër Burimore, emërtesës, strukturës dhe organikës";
Urdhri nr. 90, datë 30. 04. 2024 "Miratimin e rregullores tip për rioganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore si dhe mënyrën e rioganizimit dhe funksionimit të tyre.";
Rregullores së brendshme për nevojat specifike për mbarëvajtjen e veprimtarisë në Qendrën Burimore për Nxënësit që Nuk Dëgjojnë,

URDHËROJ

Shpalljen e konkursit për 1 (një) pozicion:
"Specialist në Departamentin e Identifikimit dhe Vlerësimit të Nevojave Arsimore të Nxënësve me Aftësi të Kufizuara", në Departamentin e Identifikimit dhe Vlerësimit të Nevojave Arsimore të Nxënësve me Aftësi të Kufizuara, në Qendrën Burimore Për Nxënësit që Nuk Dëgjojnë.
Kategoria/ klasa e pagës; Sipas VKM 425, datë 26.06.2024 (punonjës jo arsimor/ specialist/ master)

1. ***Kriteret e përgjithshme të kualifikimit janë:***
   a) Të jetë shtetas shqiptar
   b) Të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;
   c) Të mos jetë në kushte shëndetësore që nuk lejojnë te kryejë detyrën përkatëse;

d) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

2. ***Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon.***

a. Të zotërojë diplomë të ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional i Pedagogjisë Sociale (në përputhje me nevojat specifike për këtë vend të veçantë pune);
b. Të zotërojë njohuri bazë në kompjuter;
c. Zotërimi i gjuhëve të huaja, përbën avantazh gjuha angleze (certifikata, dëshmi);
d. Të ketë njohuri bazike të gjuhës së shenjave;

2.1 Kriteret e Veçanta / të Posaçme të kualifikimit:

Në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes do t'u jepet përparësi kandidatëve të cilët, përveç plotësimit të kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në këtë urdhër, zotërojnë edhe përvojë dhe kualifikime të tjera profesionale, si më poshtë:

a) Të kenë përvojë të mëparshme pune në administratën publike ose në sektorin privat, në pozicione të njëjta, të ngjashme ose të përafërta me pozicionin për të cilin konkurrojnë;

b) Të paraqesin vlerësime pozitive të performancës në punë nga eprori i drejtpërdrejtë ose rekomandime pozitive nga punëdhënësit e mëparshëm;

c) Të kenë kryer trajnime, kualifikime ose formime profesionale shtesë që lidhen me fushën e veprimtarisë së pozicionit të punës.

3. ***Dokumentacioni që duhet dorëzuar.***

Kandidatët aplikantë për këtë pozicion pune duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë për shprehjen e interesit për pozicionin e shpallur;
2. CV/Jetëshkrim;
3. Fotokopje të dokumentit të identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë);
4. Certifikatë personale dhe certifikatë e gjendjes familjare;
5. Diplomë të nivelit "Master Profesional" në Shkenca Sociale në profilin Punë Sociale dhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë bashkë me listën e notave. *Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;*
6. Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
7. Vërtetim të gjendjes gjyqësore nga prokuroria dhe gjykata;
8. Dëshmi penaliteti;
9. Vetëdeklarim të gjëndjes së konfliktit të interesit;
10. Formularin e vlerësimit të fundit të punës nga eprori direkt;
11. Vërtetim nga punëdhënësi aktual që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
12. Raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë;
13. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve/kritereve të mësipërme të kualifikimit, si dhe trajnime, kualifikime, arsimim shtesë, vlerësime/rekomandime pozitive, apo të tjera të përmëndura në CV/Jetëshkrim.

Dokumentet duhet të jenë origjinalë ose fotokopje të vërtetuara me noteri dhe mosparaqitja e plotë e dokumentacionit të sipërcituar, sjell skualifikimin e kandidatit.

3.1 Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit:

Dokumentacioni do të dorëzohet në zyrën e arkiv-protokollin e institucionit dorazi ose me postë, brenda orarit zyrtar të punës nga dita e hënë - e premte, ora 08.00 - 14.00, në adresën: Qendra Burimore për Nxënësit që Nuk Dëgjojnë, Rruga e Dibrës (pranë Medresesë), Tiranë.

3.2 Afati i dorëzimit të dokumentacionit:

Afati maksimal i dorëzimit/pranimit të dokumentacionit nga zyra e arkiv-protokollit të institucionit do të jetë 2 (dy) javë kalendarike, nga dita e nesërme e shpalljes së njoftimit në mjediset e institucionit në këndin e vendeve të lira të punës, në faqen zyrtare në ëeb dhe në faqen zyrtare të AKPA.

4. *Përshkrimi i përgjithshëm i punës:*

1 Të kryejë vlerësime të detajuara për të kuptuar nivelin e aftësive dhe nevojave të nxënësve që nuk dëgjojnë dhe komunikojnë , përfshirë aftësitë e perceptimit, përshtatshmërisë, dhe të tjera.

2 Të mbledhë të dhëna përmes intervistave, pyetësorëve, vëzhgimeve dhe analizës së

3 performancës së nxënësve me vështirësi dëgjimi dhe komunikimi.

4 Të identifikojë përdorimin e mjeteve të specializuara për nxënësit që nuk dëgjojne, të tilla si: programet e leximit me titra, tastierat speciale, dhe aplikacionet për ndihmë në komunikimin me gjuhë shenjash dhe vizual.

5 Të bashkëpunojë me mësuesit, ndihmës mësuesit, specialistët e teknologjisë asistive, interpretët, instruktorët e Gjuhës së shenjave dhe anëtarët të departamentit të identifikimit të nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe komunikim.

6 Të sigurojë mbështetje për prindërit e nxënësve që nuk dëgjojnë, duke i udhëzuar e ndihmuar se si mund të krijojnë një mjedis të përshtatshëm mësimor dhe të mbështesin zhvillimin e aftësive të fëmijëve të tyre në shtëpi.

7 Të menaxhojë burime për të ndihmuar nxënësit, duke përfshirë mjetet didaktike dhe mbështetjen teknologjike.

8 Të hulumtojë rreth përshtatjes së arsyeshme dhe praktikave të arsimit gjithëpërfshirës.

9 Të përgatisë raporte të detajuara me rekomandime praktike.

10 Të njohë mjetet e veçanta në punën me nxënësit që nuk dëgjojnë, si edhe të zotërojë aftësi të komunikimit në Gjuhën e shenjave shqipe dhe të njohë materialet didaktike të përdorura nga nxënësit dhe punonjësit në Qendrën Burimore për Nxënësit që Nuk Dëgjojnë.

11 Të njohë mjetet e posaçme të përdorura për plotësimin e nevojave arsimore për nxënësit me vështirësi në dëgjim dhe komunikim që ndjekin shkollat e zakonshme.

5. *Mënyra e përzgjedhjes/kualifikimit të kandidatëve*

Përzgjedhja/kualifikimi i kandidatëve do të kryhet i ndarë në 2 faza si më poshtë:

I. 60 pikë nga vlerësimi i dokumentacionit të sipërcituar të depozituar nga kandidatët në institucion, nga komisioni i vlerësimit i ngritur për këtë qëllim;

II. 40 pikë nga intervistimi me gojë i kandidatëve nga komisioni i vlerësimit, të cilët do të vlerësohen në lidhje me:

- 15 pikë nga njohuritë, aftësitë në lidhje me punën;

15 pikë nga eksperiencat e tyre të mëparshme;
10 pikë nga motivimi, aspiratat dhe pritshmërite e tyre për punën;

Si eksperiencë në profesion, e cila vlerësohet me maksimumi 10 pikë do të konsiderohet vetëm eksperienca në profesion.
Intervista me gojë do të fokusohet në njohuritë profesionale të fushës së aplikimit.

6. Njoftimi i kandidatëve dhe e drejta e ankimit.

Brenda 2 (dy) ditëve pune pas përfundimit të afatit të pranimit të aplikimeve, kandidatët njoftohen mbi vlerësimin e fazës së I-rë si dhe mbi vendin, datën dhe orën e zhvillimit të fazës së II-të (intervistës me gojë).

Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankim ndaj rezultatit të vlerësimit brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit për rezultatin, nëpërmjet adresës elektronike zyrtare të institucionit, dorazi pranë institucionit ose nëpërmjet shërbimit postar.